



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:230836

Datë: 05.11.2019

Numri i dokumentit: 00626178

P.nr.475/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE-DEGA SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Mentor Hajraj dhe procesmbajtësen Aferdita Isufi, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit N.L. nga fsh. P., komuna e S., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.2675/2019, të dt.02.10.2019, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me dt.05.11.2019, mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.2675/2019, të dt.02.10.2019, dhe gjykata e jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari N.L., i biri i A., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në fsh. P., komuna e S., ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: *numri personal...*

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: nga data e papërcaktuar e deri me datën 19.09.2018, 12.11.2018 dhe 19.12.2018 me rastin e kontrollit është konstatuar se i njëjti në mënyrë të kundërligjshme ka lidhur kabllon ne kablllo furnizuese para hyrjes ne njehsorin elektrik me nr. 32631698, me të cilën ka anashkaluar njehsorin dhe mori furnizimin me energji elektrike, ne këtë mënyrë është shkaktuar dëmi i llogaritur sipas faturës DMIHP1813400 ne vlerë prej 328,08 euro, DMIHP1813919 ne vlerë prej 653,05 euro dhe DMIHP 1813922 ne vlerë prej 598,41 euro.

Me këtë ka kryer veprë penale -Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të së njëjtës dispozitë ligjore lidhur me nenet 38, 43 dhe 69 të KPRK-së, si dhe neneve 450 paragraf.1 dhe 2 nën paragraf.2.6, 453 paragraf.1, 463 paragraf.1 dhe 2, 495 paragraf.1 dhe 2 dhe nenit 365 të KPP-së, e:

G J Y K O N D Ë N I M M E G J O B Ë

Në lartësi prej **200 (dyqind) euro**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata atëherë ky dënim do t'i zëvendësohet në bazë të nenit 43 paragraf.3 të KPRK-së.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 20 euro, në emër të paushallit gjyqësor obligohet të paguaj shumën prej 10 euro, dhe në emër të Fondit për kompensimin e viktimave obligohet të paguaj shumën prej 30 euro, të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari N.L. që palës së dëmtuar K. K. për D. dhe F. me E. El. Sh.A – K., brenda afatit prej 15 ditësh pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në lartësi prej 1,579.54 Euro.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Mitrovicë -Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën, PP-II.nr.2675/2019, të dt.02.10.2019 e ka akuzuar N.L. nga fsh. P., komuna e S., për shkak të veprës penale – Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragraf.6 lidhur me paragraf.1 të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 493 paragraf.1 dhe 2 të KPP-së ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarit t'i shqiptoj urdhërin ndëshkimor – dënim me gjobë pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, me arsyetim se janë siguruar prova të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrit ndëshkimor në kuptim të nenit 495 të KPP-së.

Gjykata vlerësoi se në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të besueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor të cilat e vërtetojnë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale në fjalë si: Kallëzimi penal i K. me nr. CMS-K/DMI-455/2019 të dt. 13.08.2019, Procesverbalet e K.-it; 2110356 i dt.19.09.2018, 2110510 i dt.12.11.2018, dhe 0942096 e dt.19.12.2018, faturat DMIHP 18134000, DMIHP 1813919 dhe DMIHP 1813922, si dhe nga vështrimi në foto dokumentacion dhe shkresat tjera të lëndës, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme të cekura si me lart vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragraf.6 lidhur me paragraf.1 të KPRK-së, ngase i njëjti nga data e papërcaktuar e deri me datën 19.09.2018, 12.11.2018 dhe 19.12.2018 me rastin e kontrollit është konstatuar

se i njëjti në mënyrë të kundërligjshme ka lidhur kabllon ne kabllo furnizuese para hyrjes ne njehsorin elektrik me nr. 32631698, me të cilën ka anashkaluar njehsorin dhe mori furnizimin me energji elektrike, ne këtë mënyrë është shkaktuar dëmi i llogaritur sipas faturës DMIHP1813400 ne vlerë prej 328,08 euro, DMIHP1813919 ne vlerë prej 653,05 euro dhe DMIHP 1813922 ne vlerë prej 598,41 euro, për çka gjykata gjeti së i njëjti në aspektin penal- juridik është përgjegjës dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata i pati parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 të KPRK-së, e në rastin konkret për të njëjtin rrethanë lehtësuese gjeti rrethanat e tij personale, faktin së i njëjti është familjar, mbajtës i familjes, ndërsa rrethanë rënduese gjeti mënyrën e kryerjes se veprës penale, andaj duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura si me lart, gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke pritur me të drejt se edhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimin të parapare në nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 parag.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 parag.1 të KPP-së.

Vendimin me të cilin gjykata e ka obliguar të akuzuarin ta kompensoj palës së dëmtuar K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.A- K. në M., Rr. "A." nr. ..., gjykata e mori në bazë të nenit 463 parag.1 dhe 2 të KPP-së.

Nga se u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA SKENDERAJ
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.475/2019 me datë 05.11.2019

Procesmbajtësja:
Aferdita Isufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mentor Hajraj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të kësaj gjykate. Nëse i akuzuari në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nuk ushtron kundërshtim atëherë ky aktgjykim do të merr formën e prerë dhe do të ekzekutohet.